

Skënder Rizaj

REZISTENCA E TURMAVE SHQIPTARE KUNDËR QEVERISË OSMANE (1881-1885)

Në historiografinë shqiptare, zakonisht, mbizotëron mendimi se me rënien e Prizrenit, Gjakovës dhe Pejës (në prill-maj 1881) u shua Lidhja Shqiptare e Prizrenit. E sipas Gazmend Shpuzës „Lidhja u shpërnda më 3 maj 1881”.¹

Ky konstatim si duket ka për mbështetje raportin fals të Dervish Pashës, me të cilin e kishte njoftuar Sulltanin se si Shqipërinë (Arnavutluk) e kishte bërë „feth” (e kishte pushtuar), se si e kishte vendosur përseri „qetësinë” dhe „fatbardhësinë” etj. Pastaj Dervish Pasha e kishte shkruar një „muazere” (lutje për falje) të hollësishme, me të cilën e kishte njoftuar Sulltanin se gjëja popullsia kishte kërkuar falje dhe kishte shfaqur besnikërinë e pakufishme ndaj Tij. E në të vërtetë Pasha i kishte dërguar njerëzit e vet në qendra të ndryshme të Vilajetit të Kosovës dhe të Manastirit që të mblidhnin nënshkrime me dhunë. Në atë „muazere” ishin nënshkruar, apo i kishin venë „myhyrët” (mühür=vulë) më se 5.000 shqiptarë të „dalluar”. Kur ky akt mbi besnikërinë iu kishte kthyer Dervish pashës në Prizren, Pasha i kishte ftuar serbët dhe i kishte detyruar që edhe ata t’i vejnë *myhyrët* e vet, të cilën gjë ata edhe e bëjnë.²

Në betejat e famshme të Shtimjes, të Carralevës dhe të Dulës (prill 1881) anipse forcat ushtarake të Lidhjes u thyen para fuqive më të shumta, më të organizuara e më të armatosura osmane; dhe, anipse një pjesë e udhëheqësve të Lidhjes u vranë heroikisht në këto beteja, anipse u zunë dhe u denuan rëndë nga Gjykatat e Jashtëzakonshme Ushtarake Osmane, e disa sish u shtrënguan të arratisen para pushtetit osman ushtarak dhe të egër, të rivendosur nga Dervish pasha me forcën e armëve, Lidhja, anipse, pra, u dobësua mjaftë, megjithatë nuk u shua. Ajo, tani, kaloi në fazën e katërt të veprimtarisë së saj, në fazën e luftës partizane, në fazën e luftës popullore. Këtë situatë shumë qartë e përshkroi Thimi Mitko në qershor të vitit 1881 „Shqipëria nuk fitoi dot në luftë (në betejë — S.R.) por nuk u

¹ Gazmend Shpuzë, *Roli i masave popullore në Lidhjen Shqiptare të Prizrenit*, Studime Historike, No 4, Tiranë, 1978, 119.
² Jov. Hadži-Vasiljević, *Arbanaska Liga — Arnautska Kongra* —, Beograd, 1909, 120.

prish, nuk u fal, nuk i dha armët”.³ Këtë thënie të Thimi Mitkos duhet kuptuar se Lidhja, si përfaqësuesja e Shqiptarisë, nuk u shkatërrua, fryma revolucionare e popullit shqiptar nuk u shua dhe ajo nuk kapitulloi as ushtarakisht e as moralisht më 1881, por, përkundrazi, ajo, me disa udhëheqës të vet, që kishin mbetur pa u kapur nga pushteti osman, udhëhoqi me turmat popullore shqiptare në luftë kundër pushtetit osman edhe shumë vite me radhë. Në të vërtetë, Lidhja, në pamje, e ndërroi formën. Ajo, nga një organizatë politike publike u bë organizatë kombëtare shqiptare sekrete, siç ishte ajo e karbonarëve.⁴ Kjo provohet me disa lloj burimesh, të cilat i kemi në dispozicion, ndonëse, për këtë periudhë (1881-1885), nuk kemi pasur mundësi kohore dhe materiale, deri më tani, të bëjmë kërkime të hollësishme.

Të shohim, pra, se çfarë na thonë burimet lidhur me këto çështje. Më 22 prill 1881, pas dite, Dervisha Pasha hyri në Prizren.⁵ E, një nga tregtarët e Prizrenit, të cilët arrijtën në Selanik për të blerë mallra, me trenin e 30 prillit, e njoftoi konsullin anglez Blunt, se Dervish Pasha i kishte koncentruar forcat e veta në Prizren, porse ende nuk ishte nisur kundër Gjakovës dhe Pejës. Dervish pasha, ndërkaq, ishte duke u përpjekur që me mjete pajtuese ta përfitojë Ali Pashë Gucinë dhe udhëheqësit e tjerë shqiptarë, në mënyrë që t'i nënshtrohen pushtetit të Sulltanit.⁶

Gjenerali turk Haxhi Osman pasha, kah fundi i dekadës së parë të majit e okupon Gjakovën me dy batalione ushtarësh dhe një bateri të artilerisë malore. Po ashtu kryhet edhe nënshttrimi i Pejës. Kurse Ali pashë Gucia, i cili iu bashkua Dervish pashës në Prizren, pohoi zyrtarisht se është zotuar për të treguar besnikërinë e tij ndaj Sulltanit, dhe se ka hequr dorë nga çdo pjesëmarrje e veprimtarisë së Lidhjes Shqiptare. Për këtë shkak atij njëherit, ju siguroa një pension jetësor prej 3.000 groshësh (piashtra). Po ashtu Ali pashë Gucia u emërua edhe për kajmekam të Gucisë, pozitë të cilën tanimë e rikthei.⁷

Ndërkaq, ambasadori i Britanisë së Madhe në Stamboll, Goschen, e njoftoi Ministrin e Punëve të Jashtme të shtetit të vet, Granville, se ishte i sigurtë se klika e Pallatit të Sulltanit në Stamboll luajti lojë shumë të rrezikshme lidhur me Lidhjen Shqiptare. Porse, ky personalitet, vuri në pah, se, që në fillim të veprimtarisë së Lidhjes, tek shqiptarët kanë ekzistuar ndjenjat kombëtare shqiptare.⁸

Dervish pasha pasi që në Prizren e vendosi mytesarifin posa të emëruar, Mehmet pashën, dhe, pasi urdhëroi që një batalion redifësh (ushtria rezerve, rezervistë) nga Ferizaji ta forconte garnizonin e Prizrenit, e

³ Stefanag Pollo, *Lidhja Shqiptare e Prizrenit dhe lufta e saj për çlirimin dhe bashkimin kombëtar*, Studime Historike, No 3, Tiranë, 1978, 83.

⁴ Constantine A. Chehkrezi, A.B. (Harv.), *Albania Past and Present*, New York, The Macmillan Company, 1919, 56.

⁵ Public Record Office, London, *F.O. 195/1367; F.O. 424/114*, pp. 6,7,8; *F.O. 424/114*, pp. 13; *F.O. 424/114*, pp. 17, 18.

⁶ *F.O. 424/114*, pp. 16, 17.

⁷ *F.O. 195/1367; F.O. 424/114*, pp. 24. Raporti i Konsullit anglez në Shkodër, Kirby Green, dt. 10 maj 1881.

⁸ *F.O. 424/136*, pp. 31, raport i dt. 14 maj 1881.

një batalion tjetër, po ashtu nga Ferizaji, për ta shoqëruar atë, personalisht u nis për në Gjakovë. Dervish pasha më 24 maj iu afrua Gjakovës, me ç'rast i mbledhi komandantët e ushtrisë dhe i urdhëroi që nëpërmjet të proklamatave, ta njoftonin popullin për qëllimet e ardhjes së tij. Ai vuri në pah mbledhjen me forcë të tatimeve dhe të kontributeve të tjera për vitet që kishin kaluar si dhe rekrutimin e popullsisë. E malësorët nuk pranonin as të rekrutoheshin e as të paguanin taksa. Kurse Dervish pasha kërkonte prej tyre që të jepnin sa më shumë të holla, sepse, ai besonte, se do t'i mbetej një përqindje e konsiderueshme. Ai, në mënyrë demagogjike, u përpoq t'i përfitojë të krishterët e Gjakovës, nga të cilët kërkoi taksen e bedelisë (ekvivalent për shërbimin ushtarak) për shtatë vitet e fundit, anipse, gjithmonë ishin të liruar nga shërbimi ushtarak.⁹

Zatën më 18 maj haxhi Osman pasha u nis nga Gjakova për në Pejë, vetëm me një batalion ushtarësh dhe me një top malor. Komandanti i ushtrisë së Mitrovicës, ferik (gjeneral divizioni) Hasan pasha, ndërkaq, u urdhërua që të nisej për në Pejë me disa batalione të tija. Kurse haxhi Osman pasha, pas pranimi të delegacionit të qytetit, futet në Pejë. Më vonë, më 25 maj, në Pejë arrinë edhe Ahmet Hivzi pasha, vali i Vilajetit të Kosovës, me qëllim që ta përshëndetnin Dervish pashën i cili arriti në të njejtën ditë, i shoqëruar nga 200 kalorës. Dervish pasha ishte i shoqëruar nga Ali pashë Gucia, Ilijaz pashë Dibra dhe pashallarë të tjerë.¹⁰

Me fjalë të tjera derisa Dervish pasha përpiquej t'i shtypte shqiptarët në Prizren dhe në rrethinë, në Gjakovë dhe në vise të tjera të veriut udhëheqësit e Lidhjes Shqiptare kurrsesi nuk pranonin të dorëzoheshin dhe ta pranojnë gjendjen e re. Në viset e Gjakovës çështjen e rezistencës e marrin në duar të veta Sylejman agë Vokshi, Mustafë Lita, Bajram Gjoni, Cen Dadi dhe shumë udhëheqës të tjerë nga Malësia, Luma, Gjakova dhe Peja. Në ndërkohë kishte ikur nga burgu edhe Abdyl be Frashëri, i cili, së bashku me Sylejman Vokshin, qëndron në krye të rezistencës së shqiptarëve. Aty vjen edhe Veli beu, një nga ndihmësit e parë të Abdyl Frashërit. Këta udhëheqës bënë çmos që t'i nxisin shqiptarët kundër Portës ashtu siç vepruan edhe më parë. Këta udhëheqës të Lidhjes kanë agjitur që *shqiptarët kurrsesi nuk duhet t'i japin Sulltanit ushtarë dhe taksa dhe duheshin edhe më tutje që të vetëqeverisen*. Pastaj, këta udhëheqës i bindnin bashkatdhetarët e vet se Evropa do t'u ndihmojë. Bile ua mbushnin mendjen turmave se gjoja Evropa kishte vendosur që shqiptarët nuk duhet të japin ushtarë dhe tatim.¹¹

Madje Abdyl be Frashëri me Veli beun kanë shkruar edhe memorandume dhe ato nga Gjakova ua kanë dërguar fuqive Evropiane

⁹ HHStA, Wien, PA XVII; XXXVIII. Raport i nënkonsullit Schmucker, nga Shkupit, dt. 29 maj 1881. Këto dokumente austriake janë shfrytëzuar nëpërmjet të përkthimeve të Ahmet Abdullahut, që gjenden në Arkivin e Kosovës. Masar Rizvanolli, *Lufta e Degës së Lidhjes Shqiptare në Gjakovë*, Horizontet e Historisë, No. 3, Prishtinë, 128.

¹⁰ HHStA, Wien, PA XVII.

¹¹ Jov. Hadži-Vasiljević, *vep. e cit.*, 120. Për ikjen nga burgu të A. Frashërit flet edhe Lippich (HHStA, Wien, po aty, 7 VI 1881).

nëpërmjet të Veli beut i cili këto memorandume ua dorëzonte konsullatave në Shkodër.¹² E shpirti i kësaj lëvizjeje, tani, ishte Sylejman Vokshi.¹³

Derisa haxhi Mustafa pasha¹⁴ orvatej ta vendoste rendin e qetësinë në Gjakovë dhe në Pejë, shqiptarët, nga ana tjetër, në Sanxhakun e Jeni Pazarit tregoheshin edhe më rezistues kundër Portës dhe rendit të saj, të cilin, ajo synonte ta rivendoste. Në këto vise kishin ikur shumë shqiptarë nga krahinat e Kosovës, që kishin luftuar me ushtrinë e Dervish pashës. Në Sanxhakun e Jeni Pazarit ata organizonin rezistencë të re. Për këtë arsye atje dërgohet Ismail pasha, me një ushtri të madhe prej pesë taborësh (batalion). Meqë Ismail pasha kishte për të përballuar shumë vështirësi në Mitrovicë dhe më tej në veri kërkoi nga Dervish pasha përforcime të reja.¹⁵

Megjithëqë ushtria e Dervish pashës kishte depërtuar në Gjakovë, në Pejë, në Mitrovicë dhe në Jeni Pazar, shqiptarët nuk ishin qetësuar.¹⁶

Ismail pasha për komandant në Jeni Pazar e la ferik Hasan pashën. Ky verbërisht filloi ta zbatojë urdhërin e Dervish pashës që *askush nga qytetarët nuk guxon të mbaj armë*. Mirëpo, shqiptarët e Jeni Pazarit nuk mund të pajtoheshin me këtë. Prandaj u ngriten kundër këtij pashai, duke thënë se: „*ai don ata t'i ç'armatosë dhe pastaj t'i dorëzojë Serbisë*”. Për këtë arsye shqiptarët merren vesh që ta likuidojnë Hasan pashën. Atë e ftojnë për të biseduar në mëhallën Varosh të serbëve. Pasha shkon në bisedime vetëm me një burizanzhi. Kështu posa mbërrin në Mëhallën Varosh, mu para kishës serbe, shqiptarët e tubuar e sulmojnë me shkopinj. Atë e rrëzojnë nga kali dhe „*mezi mbetet gjallë*”. Burizanzhiu i mëshon burisë. Ushtria mblidhet, e Pasha urdhëron që me topa ta bombardojnë qytetin. Mirëpo, ushtria kur e pa Pashën e përgjakur, nuk e dëgjoi, e Pashai, „*sipas ligjit të tyre më nuk ishte komandant i tyre, e qyteti dhe qytetarët mbesin të ruajtur*”. Kështu, Hasan pasha i rrahur, të nesërmen nis për në Stamboll. Mirëpo, duke kaluar nëpërmjet të Rogoznës pasha vdes dhe varroset në Mitrovicë.¹⁷

Nga ana tjetër Dervish pasha qëndroi në Pejë vetëm dy ditë, deri më 27 maj: Mandej, sipas Schmuckerit, u kthye, nëpërmjet Gjakovës për në Prizren, ku duhej ta mbante një kuvend (meclis) me prijsit shqiptarë, të cilët i mori me veti nga Peja dhe Gjakova, me qëllim që t'i bindin shqiptarët për mbledhjen e tatimit dhe të rekrutimit të ushtarëve. E malësorët refuzonin t'u binden urdhërave dhe ligjeve të Portës. Çetat shqiptare duken edhe në Kaçanik.¹⁸

Ndërsa konsulli anglez Kirby Green, largimin e shpejtë të Dervish pashës nga Peja e shpjegoi krejtësisht ndryshe nga zëvendëskonsulli

¹² *Po aty*.

¹³ *Po aty*, 121.

¹⁴ Në dokumentet angleze dhe austriake: haxhi Osman pasha, dhe Mustafa pasha. Ose janë dy personalitete, ose fjala është për një njeri.

¹⁵ J o v. H a d ž i - V a s i l j e v i ć, *vep. e cit.*, 122.

¹⁶ *Po aty*.

¹⁷ *Po aty*, 123.

¹⁸ HHStA, Wien, *PA XVII, XXXVIII*. Raporti i nënkonsullit Schmucker, nga Shkupi, dt. 2 qershor 1881.

austriak Schmucker. Kështu, sipas K. Greenit, i cili mendimin e vet e mbështet në informatën e marrur nga një autoritet osman të shquar, Dervish pasha detyrohet ta lërë Pejën me nxitim. Sepse Pashës i duhej ta merrte përsëri Prizrenin. E shkuarja e tij prej Pejës për në Prizren nuk ishte kryer nëpërmjet të Gjakovës, por nëpërmjet të një rruge përgjithsisht jo të përdorur, ngase Ali pashë Gucia kishte marrë vesh se malësorët rreth e përfaqë Gjakovës dhe Pejës ishin duke përgatitur një pusi kundër Dervish pashës. Dhe, Ali pashë Gucia, kishte frikë që shqiptarët mos po zhvillonin edhe sulm haptas kundër gjeneralit Dervish pasha. Për këtë arsye Ali pasha e detyroi Dervishin që ta braktisë Pejën menjëherë, dhe ta ribashkojë ushtrinë e tij në Prizren. Mandej, Greeni konstaton se efekti i parë i sukseseve të Dervish pashës u shua, e Dervish pashën mund ta gjejë i njëjti fat i Mehmet Ali pashës.¹⁹

Nga ana tjetër anglezi Bertram Buxton, i cili e viziton Prizrenin më 31 maj dhe 1 qershor, na informon sa vijon: Në Gjakovë ishte arrestuar Shaip aga, nënkryetar i Lidhjes Shqiptare, kurse haxhi Ymer Prizreni, kryetar i Lidhjes, dhe Sylejman Vokshi, anëtar i Qeverisë së Përkohshme Shqiptare, ishin ende të lirë. Mirëpo, Dervish pasha nuk e lejoi B. Buxtonin që ta vizitojë Pejën dhe Gjakovën, duke u arsyetuar se atje ende nuk kishte pasur kohë për t'i vënë punët në rregull, dhe se situata e këtyre qyteteve ishte e barabart me atë të Irlandës. Madje Dervish pasha këtij anglezi nuk i jep kuaj për të shkuar në malin Sharr prej nga dëshironte ta vështronte Gjakovën dhe Pejën, ku, asnjë njëri nuk mund të shkonte.²⁰

Anglezi i zënë ngoje, në raportin e tij, cekë edhe këtë: Dervish pasha dëshironte sa më parë atë ta nxjerr jashtë Prizrenit dhe të niset për në Shkodër; me të përshendetet vetëm Mustafa pasha, komandant i dytë i Dervish pashës, dhe vetëm atëherë kur atë e fton Anglezi; Ali pashë Gucia, i cili gjendej në atë kohë në Prizren për të lidhur marrëveshje me Dervish pashën, refuzon ta pranojë; Dervish pasha e çarmatosi popullsinë e krahinave të okupuara dhe vuri cenzurë mbi të gjitha letrat që vinin me postë; Dervish pasha është duke mbledhur taksa me rigorozitet, taksa këto që nuk ishin mbledhur katër vjet, e nëse mungonte ngarkuesi i taksave atëherë detyroheshin ta paguanin kusherinjtë e tij, apo të burgosen.²¹ Pra, situata politike, në Rrafshin e Dukagjinit aspak nuk ishte në të mirë të administratës osmane, të cilën, përpiquej Dervish pasha për ta rivendosur, anipse, formalisht, Prizreni, Gjakova dhe Peja, konsideroheshin si qytete të okupuara.

Edhe disa priftërinj nga Prizreni të cilët arrijnë në Shkodër në javën e parë të qershorit njoftojnë se situata në Prizren ishte e paqartë ende.²²

¹⁹ F.O. 195/1367; F.O. 424/115, pp. 16, K.Green kontit Granville, Shkodër, 6 qershor 1881.

²⁰ F.O. 195/1367; F.O. 424/115, pp. 17, 18.

²¹ F.O. 195/1367; F.O. 424/115, pp. 17, 18. Mr. Bertram Buxtoni e raporton Kirby Greenin, në Shkodër, më 6 qershor 1881.

²² HHStA. Wien, PA XVII, XXXVIII. Raport i konsullit të përgjithshëm Lippich — baronit von Haymerle, Shkodër, dt. 7 qershor 1881.

Duke pasur parasysh të dhënat austriake dhe angleze marrim vesh se Dervish pashës nuk i shkoi përdore, me një aksion të furishëm, që ta gjunjëzojë „Arnavudllëkun”, apo „Viset e Lidhjes së Prizrenit”. Pra, me masa drastike dhe ushtarake, pat sukses Pasha gjakatar që në Prizren, Gjakovë, Pejë dhe në qendra të tjera të Vilajetit të Kosovës dhe të Manastirit, të rivendos një farë pushteti civil dhe ushtarak, por në këto krahina fare nuk u vu qetësia dhe rendi, të cilën e kështu pasë vënë Lidhja Shqiptare. Përkundrazi. Shqiptarët, të prirë nga disa udhëheqës të Lidhjes, varësisht nga rrethanat e reja të krijuara në forma të ndryshme rezistojnë kundër Portës. Malësorët refuzojnë të japin rekrutë për Portën dhe të paguajnë tatime retrospektive. E haxhi Ymer efendi Prizreni, „udhëheqës i agjitorëve dhe shpirti e zemra e Lëvizjes, gjendej shëndosh e mirë në mes të ithtarëve të vet malësorë”.²³ Nga prijatarët vetëm Shaip aga dhe Abdyl Frashëri gjendeshin në burg.²⁴ Të tjerët, anipse morën pjesë aktive në kryengritje, që u zhvillua para një kohe, tani gëzojnë liri të plotë. Aq më tepër, që në javën e parë të qershorit, fillojnë të qarkullojnë lajmet se pas tërheqjes së Dervish pashës do të kthehet gjendja e mëparëshme, meqë nuk do të ketë kush ta çaramatosë popullsinë, e efektivet e garnizoneve do të redukohen shumë.²⁵

Madje, siç duket, as Porta nuk ishte e bindur plotësisht se qetësia do të vazhdojë shumë kohë. Për këtë arsye ajo mendoi t'i marrë si peng bijtë e prijatarëve shqiptarë në zë në Stamboll, ku do të shërbenin në rojën e nderit të Sulltanit.²⁶

Prandaj, siç mësojmë nga anglezi bashkëkohës, Blunt, Dervish pasha detyrohet të lëshojë pe dhe të ndjek një politikë të matur dhe të butë ndaj udhëheqësve shqiptarë. Sepse Dervish pashës i hyri frika në palc për shkak të operacioneve të tij të fundit të marra kundër Lidhjes. E malësorët e Gjakovës konsideroheshin si shqiptarë më revolucionar. As Dibra dhe as Mati ende nuk ishin riokupuar. Për këtë shkak Dervish pasha përgatitej që të shkojë edhe atje dhe t'i nënshtrojë.²⁷

Për ruajtjen e qetësitë dhe për vendosjen e pushtetit të ri osman në qytetin e Kosovës Dervish pasha vendosi ushtri të mëdha në to. Kështu, Prizreni okupohej nga dhjetë batalione këmbësorësh, me dy bateri të artilerisë, dhe nga gjysmë regjimenti kalorësish. Pushteti civil iu kishte besuar ferik Mehmed pashës, i cili mirrej me rivendosjen e pushtetit të ri, nën mbikëqyrjen e Dervish pashës.²⁸

Gjakovën e okuponin tetë batalione këmbësorësh, dy bateri të artilerisë, dhe një skuadër e kavalerisë, nën komandën e ferik Musa Qazim pashës, i cili, njëkohësisht, e ushtronte edhe pushtetin civil.²⁹

²³ HHStA, Wien, PA XVII, XXXVIII. Raporti i zëvendëskonsullit Schmucker baronit von Haymerle, Shkup. 9 qershor 1881.

²⁴ Po aty.

²⁵ Po aty.

²⁶ Po aty.

²⁷ F.O. 424/115, pp. 26, 27. Konsulli i përgjithshëm Blunt kontit Granville, Selanik, 14 qershor 1881.

²⁸ Po aty.

²⁹ Po aty.

Ndërkaq, në Pejë ishin të stacionuar tri batalione këmbësorësh, një bateri e artilerisë, dhe një skuadër e kavalerisë; Ferizajin e okuponin 2 batalione këmbësorësh; Prishtinën 2 batalione këmbësorësh; Shkupin 1 batalion këmbësorësh; Dibrën 2 batalione; Mitrovicën 3 ose 4 batalione këmbësorësh dhe 1 bateri e artilerisë. Armata e Dervish pashës i përdorte edhe kufitarët e kufirit bullgar dhe serb, nën komandën e ferik Ahmet Hifzi pashës, vali i Vilajetit të Kosovës, dhe Tahir pashës, mytesarif të Sanxhakut të Shkupit.³⁰

Kah gjysma e qershorit haxhi Ymer Prizreni, kryetar i Lidhjes Shqiptare të Prizrenit, u detyrua që të ikë për në Ulqin, kurse familja e tij, e përbërë nga bashkëshortja dhe tre fëmijë, u internua në Selanik, ku u vu nën mbikëqyrjen e policisë.³¹

Megjithatë fiset e Malësisë dhe të Rekës, rrethina e Gjakovës, edhe më tej nuk lejonin regjistrimin e popullsisë, dhe refuzonin të jepnin rekrutë dhe tatime për Sulltanin. Kurse Dervish pasha i shmanget përdorimit të forcës ushtarake kundër tyre.³²

Dervish pasha në shtypjen e shqiptarëve, nuk e përdori vetëm forcën e ushtrisë, por edhe dinakërinë, etj. Kështu, ai i ftoi përfaqësuesit e shqiptarëve myslimanë të Shqiptarisë Veriore në rezistencën e tij të asaj kohe, në Prizren. Në mes të pjesëmarrësve ishin: Iljaz, Sadik dhe Abdullah pasha nga Dibra, Hasan dhe Sadik pasha nga Tetova, pastaj Ali pashë Gucia, Shaban dhe Ahmet beu.³³

Derisa Dervish pasha kuvendonte me disa pashallarë dhe bejlerë shqiptarë kapitulant, fiset e Malësisë, e sidomos Krasniqja dhe Gashi vazhdonin rezistencën e tyre të zakonshme. Ata kurrsesi nuk i nënshtrohen urdhërave të Portës, duke rezistuar përpjekjen e Dervish pashës në mbledhjen e tatimeve dhe të rekrutimit. Tani, meqenëse haxhi Ymer Prizreni u detyrua të largohet për në Ulqin, Sylejman Vokshi dhe Ali Ibra e morën udhëheqjen e Lëvizjes Shqiptare në duar të veta. Këta udhëheqës i hedhin poshtë të gjitha ofertat e marshalit turk, Dervish pashës. Jo vetëm kaq, Sylejman Vokshi, si prijatar i Lëvizjes së turmave shqiptare, përgatiste një aksion të fortë kundër Dervish pashës. E ky pashë i Perandorisë Osmane u detyrua të sillet më me kujdes ndaj kazave të Gjakovës dhe të Pejës. Kështu, në vend që të rekrutonte rekrutë-nizamë, kundër së cilës gjë kundërshtonin shqiptarët, Dervish pasha u tha organeve osmane që të zgjedhin vetëm 500 redifë (rezervistë).³⁴

Meqë rezistenca e Malësisë dhe e Rekës vazhdonte me intensitet të madh, e rrethina e Hasit të Prizrenit kundërshtoi rekrutimin, Dervish pasha, më 28 qershor, e grishi kuvendin (meclis) madhështor, në të cilin morën pjesë shumë bujarë nga Shkodra, nga Dibra dhe Tetova. Në këtë

³⁰ *Pa. aty.*

³¹ *Pa. aty.*

³² HHStA, Wien. PA XVII; XXXVIII. Nënkonsulli Schmucker baronit won Haymerle, Shkup, 14 qershor 1881.

³³

kuvend Dervish pasha thotë: „Unë jamë këtu për të rivendosur paqën e rendin, dhe, pas një pune dymujore, mendoj se ia kam arrijtur këtij qëllimi. Tatimet u mblodhën, rekrutimet u sendertuan dhe kudo mbretëron qetësia dhe siguria. Çka mendoni ju? A jeni të kënaqur me këtë gjendje? „Kuptohet, në atë rast, mbretëron qetësia në sallë dhe askush nuk guxon t'i kundërshtojë Pashës, por të gjithë e tundin kokën në shenjë të pohimit. Pas kësaj, menjëherë, Dervish pasha u urdhëroi të pranishmëvet që ta nënshkruajnë një „mazbatë“³⁵ të gatshme, përmbajtja e së cilës, për shumicën dërmuese të të pranishmëve, ishte dhe mbeti e panjohur.³⁶

Mirëpo, Dervish pasha, shkoi edhe më tutje. Kryeartikulli i Gazetës së Vilajetit të Kosovës, dërguar nga Prizreni, artikull ky i cili dihej se ishte i vet Dervish pashës, fliste për sukseset e pashës në fjalë. Aty vihen në pah sukseset e arrijtura të Dervish pashës, me qëllim që ta bindte popullsinë e asaj ane se Pashës në fjalë i shkoi përdore ta „qetësojë vendin“ dhe ta „vendosë rendin“. Por askush nuk i besonte artikullit, meqë Dervish pasha hyri në Kosovë me shumë ushtarë. Pastaj, prania e madhe e ushtrisë osmane nuk garantonte zgjatjen e „paqës“ dhe të „rendit“.³⁷

Të gjitha këto pohime nuk ishin të vërteta Malësia e Gjakovës, përkundrazi, iu kishte kërcënuar ferik haxhi Osman pashës se edhe ai po qe se nuk do tërhiqej sa më parë nga Gjakova do ta përfundonte jetën sikurse Mehmet Ali pashë Maxhari (1878). Pas këtij kërcënimi kategorik të shqiptarëve, më 1 korrik 1881, pasha në fjalë detyrohet ta lëshojë përkohësisht Gjakovën dhe të vendosej në Prizren, ku ishte Dervish pasha,³⁸ kryekomandanti special i Sulltanit.

Gjatë korrikut të vitit 1881 popullsia e Gjakovës me rrethinë e vazhdoi qëndresën kundër përpjekjeve të Dervish pashës për t'i nënshtruar këto anë, anipse, ai, në fillim, mori masa energjike, bile edhe kundër qeveritarëve, të cilët i kishte emëruar personalisht. Në këtë mënyrë, ai, burgosi kajmekamin e Gjakovës, Riza be Kryeziun, të cilin e dërgoi në Prizren. Riza beu u dënua me 5 vjet burgim të rëndë dhe u internua në Diarbekir (në Anadoll). Kurse vartësit e tij, një toger u dënua me 6 vjet, dhe 2 xhandarë me nga 1 vjet internim në Rodos. Mirëpo, për t'i qetësuar banorët e vendit, Dervish pasha shumë herë hoqi dorë nga kërkesat e veta. Në këtë mënyrë në Gjakovë të gjithë kuajt, iu kthyen pronarëve të tyre që u rekuizuan për qëllime ushtarake.³⁹

Më 24 korrik 1881, në Gjakovë, u mbyll pazari për shkak se banorët e saj kishin refuzuar rekrutimin e redifëve dhe regjistrimin e popullsisë. Kjo ishte një nga dëshmitë që tregonte se pushteti osman kishte gabuar në llogaritë e veta, se, gjëja, në Gjakovë dhe në Has ia kishte mbërri qëllimit në nënshtrimin e popullsisë. Zatën, Dervish pashës „shumë pak i shkoi

³⁵ Mazbata: raport zyrtar; protokol; vendim i një kuvendi; vendim i një kuvendi i cili nënshkruhet prej të pranishmëve; *kararname*.

³⁶ HHStA, Wien, PA XVII, XXXVIII. Nënkonsulli Schmucker baronit von Haymerle. Shkup, 3 korrik 1881.

³⁷ HHStA, Wien, PA XVII, XXXVIII. Nënkonsulli Schmucker baronit Haymerle. Shkup, 7 korrik 1881.

³⁸ Masar Rizvanolli, *vep. e cit.*, 130.

³⁹ *Po aty*, 131.

përdore t'i zbatojë urdhërat e veta'', thotë Schmucker, diplomat austriak në Shkup. Për këtë shkak në ndërkohë Dervish pasha kishte pranuar të kontaktojë me kundërshtarët e tij, Sylejman Vokshin, haxhi Ymer Prizrenin,⁴⁰ Ali Ibrën dhe krerët e tjerë të fiseve të ndryshme të rrethit të Gjakovës që gjendeshin në fshatin Shipshaj të Gashit, duke u përpjekur që t'ia arrijë qëllimeve të tija. Ai i dërgoi dy përfaqësuesë të tij me dhurata dhe me premtime të bukura, siç vepronte zakonisht, por ata nuk patën sukses në misionin e tyre. Madje, mezi mbërritën të kthehen dhe të shpëtojnë kokën.⁴¹

Malësorët e Rekës, të Malësisë, të Hasit si dhe ata që ishin të fshehur në viset e Gjakovës mbanin lidhje të rregullta midis tyre duke treguar një unitet të madh. Ata jo vetëm që nuk pranonin rekrutimin, regjistrimin e popullsisë, çarmatimin dhe pagimin e tatimeve, por, të zhgënjyer nga qëndrimi dyfytirësh i Dervish pashës dhe i përfaqësuesëve të tij, filluan të ndërmarrin aksione të armatosura kundër ushtrisë osmane dhe komandantëve të saj. Me këtë rast u vranë shumë ushtarë të Dervish pashës. Mirëpo, për t'u hakmarrë për ushtarët e vranë dhe për t'i nënshtuar malësorët e Rekës, të Malësisë dhe të Hasit, ferik haxhi Osman pasha u nis në krye të 4 batalioneve, në mbrëmjen midis 10 dhe 11 gushtit 1881, në drejtim të Rekës prej nga do të vazhdonte në Krasniqe dhe në Gash. Porse ushtria partizane e shqiptarëve e sulmoi ushtrinë osmane që ishte nisur për në Rekë, në fshatrat Dobrosh, Voksh dhe në Junik. Ato përbëheshin nga 4.000 luftëtarë, e që u shkaktuan disfatë të rëndë ushtarëve osmanë, të cilët u shtrënguan të kthehen të shpartalluar në Gjakovë duke lënë në fushëbetejë 30 të vranë, shumë pushkë dhe 60 arka municion.⁴²

Jo vetëm kaq. Në gjysmen e parë të gushtit simptomat e trazirave të mëdha duken në gjithë Shqipërinë Veriore. Këto trazira në mënyrë të veçantë duken në rrethin e Pejës, të Gjakovës dhe të Dibrës. Regjistrimi i popullsisë, i urdhëruar nga Dervish pasha, me gjithë fuqinë e banorëve të këtyre anëve, u refuzua. Pra, përpjekjet e Dervish pashës, për ta qetësuar vendin, shkuan huq.⁴³

Për këtë situatë shumë serioze konsulli anglez në Shkodër, Kirby Green, e duke u mbështetur në informatorët e tij besnik nga Kosova, e njofton Qeverinë e vet. Sipas tij, Dervish pasha, kah gjysma e gushtit, kishte hasur në kundërshtim të fortë të malësorët përreth Gjakovës. Malësorët nuk pranuan kurrsesi t'i japin ushtarë Portës. Mirëpo, Dervish pasha dhelpnak, duke vërejtur vendosmërinë e malësorëve, i ftoi udhëheqësit e malësorëve në Prizren, të cilëve u premtoi se fiset e tyre nuk do t'i nënshtrohen shërbimit të rregulltë ushtarak, me kusht që të pushojnë së kundërshtuari ndaj autoriteteve osmane. Malësorët, nga ana tjetër, në mënyrë që të ishin të gatshëm për çdo befasi, bashkohen dhe përbetohen

⁴⁰ Haxhi Ymer Prizreni kthehet nga Ulqini, përkohësisht.

⁴¹ Masar Rizvanolli, *vep. e cit.*

⁴² *Po aty*, 132.

⁴³ *F.O. 424/118*, pp. 6. Konsulli Blunt kontit Granville, Selanik, 13 gusht 1881.

me *besë* se do t'i dalin në ndihmë njëri tjetrit kurdoherë që të jet nevoja. Malësorët, pra, dhanë *besën* se do të kundërshtojnë, deri në pikën e fundit të gjakut, madje orvatjen më të vogël të Pashës turk, nëse cenohen „privilegjet” e tyre, ose në rast se përpiquej që t'i nënshtrojë rekrutimit ushtarak.⁴⁴

Pastaj, Kirby Green, në raportin e tij, thekson se Dervish pasha për ta provuar vlerën e „besës” së dhënë të malësorëve, në javën e kaluar, d.m.th. kah 15 gushti (22-7 = 15), e urdhëroi haxhi Osman pashën, i cili qe komandant i ushtrisë osmane në Gjakovë, që t'i dërgojë dy batalione *nizamësh*, (ushtarë të rregullt) në katundin e rëndësishëm, në Isniq, i cili gjendet në mes Gjakovës dhe Pejës, me detyrë që katundarët t'i nënshtrohen rekrutimit ushtarak.⁴⁵

Ndërkaq, kur nizamët arrijnë në qafën e malit, në afërsi të Isniqit, papritmas kuptojnë se ishin të rrethuar prej ushtrisë shqiptare, që kapte nja 3.000 veta. Britmat luftarake dhe të shtënat e shqiptarëve dëgjohen në të katër anët. Paniqë e kaploi përnjëherë tërë ushtrinë osmane. Ajo shkatërrohet dhe ushtarët ia japin këmbëve në drejtime të ndryshme, gjer në Gjakovë.⁴⁶

Fitorja e katundarëve të Isniqit jehoi shumë shpejt. Kështu shumë malësorë mblidhen përnjëherë. Dhe, pas kthimit të ushtrisë osmane fluturimthi malësorët duken në afërsi të Gjakovës, me një fuqi prej 7.000 burrash, me qëllim që ta sulmonin haxhi Osman pashën dhe batalionet e tij.⁴⁷

Sylejman Vokshi, i cili strehohej te malësorët e Krasniqës, tani dual fitues. Dhe, pas alarmimit të menjëhershëm në Gjakovë, njerëzit e fisit të tij terhiqen të determinuar që të mbështeten në fuqinë mbrojtëse të maleve të tyre.⁴⁸

Këto fitore të shqiptarëve i dhanë me kuptua Dervish pashës së kryengritja e malësorëve shqiptarë të Gjakovës, të Pejës dhe të Dibrës mund të bëhej shumë serioze dhe e karakterit të përgjithshëm. Prandaj për ta mbajtur autoritetin e pushtetit osman me fuqinë ushtarake, në këto krahina shqiptare, Dervish pasha kërkoi nga Porta e Lartë që t'i dërgohen me nxitim përforcime të reja prej 8 batalionesh të këmbësorisë dhe dy bateri të topave malore.⁴⁹

Disfata e fundit e ushtrisë së Dervish pashës, në afërsi të Gjakovës, ndikoi negativisht edhe tek shqiptarët e besimit myslimanë të Shkodrës, të cilëve ia kishte imponuar autoritetin e vet që nga fundi i vitit 1880. Tani, shqiptarët e Vilajetit të Shkodrës, vendosin që të heqin dorë nga nderimi i komisarit të lartë turk, Dervish pasha.⁵⁰

⁴⁴ F.O. 195/1367; F.O. 424/118, pp. 2. Konsulli Kirby Green kontit Granville, Shkodër, 22 gusht 1881.

⁴⁵ Po aty.

⁴⁶ Po aty.

⁴⁷ Po aty.

⁴⁸ Po aty.

⁴⁹ F.O. 424/118, pp. 32. Konsulli Blunt kontit Granville, Selanik, 28 gusht 1881.

⁵⁰ F.O. 424/118, pp. 27. Kirby Green kontit Granville, Shkodër, 30 gusht 1881.

Lidhur me këto ngjarje të bujshme „Gazeta serbe” („Srpske novine”) thotë: „Tanimë u mbushën plot katër muaj që u ngriten shqiptarët kundër ushtrisë turke dhe, gjer më tani, lëvizja shqiptare jo vetëm që nuk u shua, por përkundrazi mori aq hov sa që rekianët, në betejën e fundit, e thyen ushtrinë e Dervishit. Plot katër muaj lufton Dervish pasha kundër kryengritësve shqiptarë dhe në vend që t'i kishte vrarë, ai shkaktoi qendresë të atillë kundër ushtrisë së Sulltanit sa që kryengritësit sot janë zot të Shqipërisë së Epërme. Qeveria Osmane (Porta e Lartë), e pakënaqur me këtë rezultat, vendosi... t'i dërgojë dhjetë batalione të reja në Prizren, prej nga Dervishi mendonte ta fillojë fushatën e re kundër shqiptarëve. Dhe me të vërtetë ishte koha e fundit që t'i dërgojë ushtria ndihmë, Dervishit sepse, pos disfatës së ushtrisë së Dervishit, të cilën e thyen terësisht rekianët, shqiptarët e Gjakovës morën guxim aq të madh sa që po përgatiten për ofensivë kundër ushtrisë perandorake. Turqit shpresojnë se Dervishi me batalionet e reja do të jetë në gjendje ta shuajë kryengritjen... ndonëse prapëseprapë dyshojnë se do t'i shkojë për dore, që pas kësaj, t'i qetësojë malësorët shqiptarë, sepse e dinë nga përvoja se është më lehtë t'i mundish se sa t'i qetësosh shqiptarët”.⁵¹

Për sukseset dhe mossukseset e Dervish pashës, dhe për fuqinë ushtarake të tij, që kishte në dispozicion, deri në shtator të vitit 1881, për nënshkrimin e shqiptarëve, konsulli Blunt raporton:

Regjistrimi i popullsisë ishte bërë në Shkup, Tetovë, Kaçanik, Prishtinë, Mitrovicë dhe në Prizren, kurse këto masa nuk ishin zbatuar në Dibër e Poshtme dhe të Sipërme, e sidomos në kaza të Pejës dhe të Gjakovës. Malësorët e këtyre krahinave rezistonin, siç ishte rasti i Rekës, nahije e madhe e kazasë së Gjakovës. Shqiptarët me forcë i kanë dëbuar zyrtarët turq, të cilët kërkojnë ta kryejnë regjistrimin e popullsisë. Në Dibër nuk ekzistonin përpjekjet serioze të autoriteteve osmane për përtrirjen e administratës së vet. Nga 24 batalione këmbësorësh, sa kishte Dervish pasha në dispozicion, 18 sish ishin redifë (rezervistë). Kjo forcë ushtarake ishte e shpërndarë: 7 batalione në Prizren; 10 batalione në Gjakovë dhe në Pejë; 3 batalione në Lumë; 3 batalione në Dibër; 1 batalion në Ferizaj.⁵²

Për shkak të jehonës që pat kjo fitore, Dervish pasha përgatitej të kalonte përsëri në Gjakovë, në mënyrë që ta përmirësonte pozitën e tij. Ai ishte shumë i pakënaqur me haxhi Osman pashën, për mossukseset e tij kundër malësorëve. Për këtë arsye komandën ia besoi mytesarifit të Prizrenit, Hasan pashës.⁵³

Pas këtyre fitoreve u mblodh gjithë Malësia dhe krahinat e tjera të nahijes së Gjakovës, dhe morën vendim që t'i sulmojnë ushtritë e Dervish pashës në rast se ato nuk do të tërhiqeshin nga qyteti. Autoritetet osmane të qytetit kërkuan një afat nga përfaqësuesit e kryengritësve për t'u marrë

⁵¹ „Srpske novine”, 4 shtator 1881; Masar Rizvanolli, *vep. e cit.*, 132.

⁵² *F.O. 424/1/8*, pp. 43.

⁵³ Masar Rizvanolli, *vep. e cit.*, 133.

vesh me Dervish pashën, i cili gjithashtu kërkoi një afat deri 5 ditësh pas bajramit për t'u marrë vesh me Sulltanin, i cili duhej të vendoste për këtë çështje.⁵⁴

Nga ana tjetër kryengritësit shqiptarë të kazasë së Gjakovës, të cilët kishin vendosur për të sendertuar me çdo kusht kërkesat e veta, dërguan një delegacion te Ali pashë Gucia, për të kërkuar prej tij që t'iu kthej ndihmën dhe shërbimet, që ia kishin bërë ata më 1879-1880, gjatë mbrojtjes së Plavës dhe të Gucisë. Megjithë refuzimin e Ali pashë Gucisë për t'u dhënë ndihmë, përfaqësuesit e Gjakovës me rrethinë patën sukses për të lidhë *besën* me popullsinë e Plavës dhe të Gucisë në pengimin e Dervish pashës i cili kishte vendosur ta përtrijë pushtetin osman, ta bëjë regjistrimin e popullsisë, rekrutimin dhe mbledhjen e armëve. Madje madje ata e akuzuan Ali pashë Gucinë për shkeljen e besës dhe e nxitën kundër tij popullsinë e Gucisë, e cila e rrethoi shtëpinë e tij të fortifikuar.⁵⁵

Ngjarjet e fundit treguan se Dervish pasha edhe kësaj radhe ishte mashtruar kur mendoi se i kishte qetësuar shqiptarët e këtyre anëve. Në këtë mënyrë më 5 tetor Sylejman Vokshi dhe Ali Ibra së bashku me krerët e Malësisë dhe të Rekës, të shoqëruar nga 200 burra të armatosur, mbërrinë në Gjakovë. Për të evituar konfliktet me krerët shqiptarë edhe për të fituar besimin e tyre, ushtria osmane doli nga kazemat.⁵⁶

Në mbledhjen që u mbajt më 6 tetor 1881, në Gjakovë, krerët e lartpërmendur të fiseve i formuluan këto kërkesa, të cilat ia paraqitën autoriteteve osmane: 1) garnizoni i Gjakovës mund të kishte vetëm dy batalione ushtarë; 2) regjistrimin e popullsisë do ta bënin vetëm përfaqësuesit e popullit, pa intervenimin e Portës; 3) tatimet dhe taksat e tjera do të vjeleshin në atë masë në të cilën paguheshin në të kaluarën; 4) hedhej poshtë kërkesa për rekrutimin e ushtrisë; në rast lufte dhe nëse paraqitej nevoja krerët do t'i organizonin vet kontigjentet vullnetare ashtu siç kishin vepruar në të kaluarën, dhe 5) për numrin, rrogat dhe kombësinë e zaptive (xhandarmëria) do të ngelnin në fuqi ligjet dhe zakonet e deriatëhershme. Ata në fund deklaruan se do t'i bindeshin Portës vetëm nëse do të pranoheshin kërkesat e përmendura.⁵⁷

As shqiptarët e Dibrës nuk qëndruan duar kryq. Kështu, sipas Bluntit, pasha i Selanikut heret në mengjez kishte marrë një telegram zyrtar nga Prizreni, me të cilin ishte njoftuar se Dervish pasha dje (11 tetor 1881) në mengjez marshoi prej Prizreni për në Dibër, në krye të njëzetë batalioneve. Ushtria e Dervish pashës tani përbëhej krejtësisht prej ushtarëve të rregullt, pjesa më e madhe e të cilëve ishin nga Anadoli.⁵⁸

Pra, Dervish pashës, deri në fund të vitit 1881, i shkoi përdore të rivendosë njëfarë pushteti osman në disa qendra të Vilajetit të Kosovës dhe

⁵⁴ *Po aty*, 133.

⁵⁵ *Po aty*.

⁵⁶ *Po aty*, 136.

⁵⁷ *Po aty*.

⁵⁸ *F.O.* 424/119, pp. 29. Konsulli Blunt kontit Granville, Selanik, 12 tetor 1881.

të Manastirit, dhe t'i internonte mjaft udhëheqës të Lidhjes Shqiptare. Mirëpo nuk u arrit ajo që u kërkua nga kryekomisari i Sulltanit (Dervish pasha). Vraga që acaroi Shqipërinë Veriore ishte ajo që Dervish pasha ishte udhëzuar për të mbledhur parat e papaguara të taksave dhe t'i detyrojë për të shkuar ushtarë⁵⁹ meshkujt shqiptarë.

Me fjalë të tjera ishte e pamundur të rivendoset autoriteti i Sulltanit në Shqipërinë Veri-Lindore. Ali pashë Guçia ishte emëruar për mytesarif të Sanxhakut të Pejës, ku përfshihej edhe Gjakova dhe Guçia, vetëm e vetëm për ta qetësuar atë pjesë të Shqipërisë. Mirëpo, emërimi i Ali pashë Guçisë për mytesarif e vështirësoi akoma më shumë situatën, sepse bashkëvendësit e humbën besimin në te, besim ky të cilin, më të vërtetë, deri në fund të vitit 1880, e posedonte, kur e kishte pajisur Shqipërinë Veri-Lindore me shëmbllësë të Qeverisë Lokale.⁶⁰

Edhe gjatë vitit 1882 shqiptarët e Shqipërisë Veri-Lindore ishin aktiv, duke mos pranuar asnjë reformë të Portës së Lartë, që shkonte në dëm të interesave shqiptare.⁶¹

Mbi gjendjen politike, e cila mbretëronte në Shqipërinë Veri-Lindore, në çerekun e fundit të vitit 1882, dhe në çerekun e parë të vitit 1883, Blunti na jep një pasqyrë të qartë. Sipas tij, në Dibër ndodheshin trazirat. Në Pejë dhe në kaza të tjera të Shqipërisë Veriore, që i përkisnin Vilajetit të Kosovës, kishin filluar përsëri lëvizjet popullore. Në këto vise kishte shumë raste të vrasjeve nga pusia. Shqiptarët fare nuk i bindeshin autoriteteve osmane. P.sh. shqiptarët e Pejës, një tregtari të Selanikut, i cili kishte blerë në Pejë grurë dhe misër për Malin e Zi, ia ndaluan transportimin e drithit në fjalë nga Peja. Ky tregtar i drejtohet për ndihmë autoriteteve osmane, por këta nuk pranojnë për të ndërhyrë. Madje shqiptarët e Pejës me forcë e dëbuan këtë tregtar nga Peja.⁶²

Në Pejë, njëfarë imam Musa, në pikë të ditës, e kishte vrarë funksionarin turk, kryetarin e Gjykatës Civile dhe Penale të Pejës. Madje, autoritetet lokale osmane as që u përpoqen për ta arrestuar vrasësin, i cili jetonte në qytet plotësisht i lirë.⁶³

Nga ana tjetër, Draništa dhe njëzet katunde të tjera myslimane, të cilat i takonin kazasë së Vuçitërnës, të Vilajetit të Kosovës, kishin refuzuar për të paguar taksa Portës. Valiu i Kosovës, me këtë rast, nuk kishte marrë masa të duhura. Ai vetëm kishte formuar një Komision, nga disa anëtarë të Kuvendit (Meclis) të vet, me qëllim që t'i bindnin katundarët në fjalë që t'i respektonin autoritetet e pushtetit osman. Por pa dobi. Ky delegacion kthehet nga misioni i tij dhe e siguron Shkelqesinë e Valiut se populli kishte marrë një qëndrim shumë të rrezikshëm, duke vendosur për ta mbajtur

⁵⁹ F.O. 19/1408. Kirby Green kontit Granville, Shkodër, 3 janar 1882.

⁶⁰ F.O. 195/1408. Kirby Green kontit Granville, Shkodër, 14 shkurt 1882.

⁶¹ Instituti i Historisë në Tiranë. A. IV. 2. Konsulli i përgjithshëm i Austro-Hungarisë në Shkodër, Lippich, 16 maj 1882.

⁶² F.O. 424/136. pp. 128, 129. Konsulli Blunt kontit Granville, Selanik, 28 mars 1883.

⁶³ Po aty.

rrugën e vet, *vi et armis*, nëse ishte nevoja. E valiu nuk kishte ushtarë të mjaftueshëm për t'i nënshtruar këta shqiptarë të pabindur.⁶⁴

Edhe shkencëtari anglez, A. Evans, i cili e viziton Vilajetin e Kosovës dhe të Manastirit, në korrik 1883, jep një vlerësim mbi gjendjen reale e cila mbretëronte në atë kohë në këto vise, dhe mbi veprimtarinë e Lidhjes Shqiptare, në rrethana të reja. Në këtë mënyrë, sipas këtij anglezi të shquar, ndarja e vilajeteve të Shqipërisë së Sipërme ishte fare artificiale dhe botërisht e pakuptueshme. Kështu, ndonëse Shkupi dhe Prishtina përfshiheshin në kuadrin e Vilajetit të Kosovës, kazatë (rrethet) fqinje, gjeografikisht të pandara, siç ishte ajo e Tetovës dhe e Prizrenit, ishin venë nën administrimin e Vilajetit të Manastirit.⁶⁵ Kjo ndarje, sipas Evansit, ishte bërë për qëllime ushtarake. Sepse, në rast të qarkullimit të lëvizjes shqiptare në Sharr ushtria e të dy vilajeteve të ketë mundësi ta mposhtë atë pa ndonjë ngatërrim të shpërndarjes normale të forcave.⁶⁶

Sipas gjykimit të A. Evansit, „në momentin e tanishëm Lidhja Shqiptare mund të thuhet se është në gjum, por ka prova të hapta të vazhdimit të Lëvizjes (të Lidhjes), e kjo ishte një simptomë”. Mandej, vëren anglezi në fjalë, se në Vilajetin e Kosovës dhe në distrikte fqinje të Dardanisë së Lashtë, me siguri dominonte elementi shqiptar mbi autoritet turke ekzistuese, sepse ato nuk e kryenin detyrën. Madje në Mytesarifllëkun e Shkupit, i cili konsiderohej si krahinë shumëpaqësore e vendit, autoritet turke nuk kishin guxim të futen në ndonjë prej katundeve malore pa pasur përkrahjen e ushtrisë. Sepse malësorët shqiptarë ishin të armatosur mirë, e organet turke nuk kishin bërë përpjekje serioze për t'i çarmatosur.⁶⁷

Vlenë të përmendet edhe ky konstatim i A. Evansit: „Zyrtarët turq, e kjo është simptomë e rëndësishme, më shumë po e përkrahin vullnetin e tyre (të shqiptarëve — S.R.). Ata (turqit) po flasin me të madhe për tolerimin e idesë shqiptare të formimit të një shteti (shqiptar — S.R.) vasal nën Sulltanin, dhe i kam dëgjuar zyrtarët turq, këtu, (Shkup — S.R.) haptas duke e mallkuar Dervish pashën, i cili, duke i kapur tradhtisht udhëheqësit shqiptarë në Shkup e shquajti përkohësisht *Lidhjen*”.⁶⁸

Në Gjakovë gjendja e sigurimit publik ishte e atillë sa që *mydyri* (administruesi) nuk kishte guxim për t'i dhënë leje A. Evansit dhe bashkëshortës së tij për të dalur vetë në rrugë. Ky anglez mundi ta shikojë një pjesë të pazarit vetëm me ndërmjetësinë e *agës* lokale. Ndërsa në Pejë gjendja ishte edhe më e keqe. Ali pashë Gucia ishte mytesarif, d.m.th. qeveritar civil dhe ushtarak. Megjithatë pushteti i tij ishte mjaft i kufizuar. Në Pejë ai ishte kukull. Ai i jep leje Evansit duke e shoqëruar me një roje prej tetë shqiptarësh të armatosur,⁶⁹ që ta vizitojë pazarin.

⁶⁴ *Po aty.*

⁶⁵ Në gusht të vitit 1880 Porta e Lartë Sanxhakun e Prizrenit e shkëputi nga Vilajeti i Kosovës dhe ia bashkoi Vilajetit të Manastirit, me qëllim që ta dobësonte sa më lehtë veprimtarinë e Lidhjes Shqiptare.

⁶⁶ *F.O. 424/136*, pp. 142.

⁶⁷ *Po aty.*

⁶⁸ *Po aty.*

⁶⁹ *Po aty.*

Si duket edhe Vaso efendiu (Pashko Vaso), duke qenë mysteshar (ndihmës) i valiut të Edrenës, ndikonte në ngjarjet që zhvilloheshin në Shqipërinë Veri-Lindore. Prandaj, për ta larguar edhe këtë njeri të rrezikshëm për Portën, atë, sikurse u veprua, më 1877, me Ismail Qemalin, Sulltani e transferoi për vali të Libanit (1883), për një periudhë dhjetëvjeçare, ku edhe vdiq (1892), vetëm e vetëm, që ky personalitet me ndikim tek shqiptarët të jetë sa më largë prej tyre. Prej kësaj kohe ai mori edhe titullin e pashës.⁷⁰

Se shqiptarët nuk ishin qetësuar, por ishin gjithnjë aktiv, na dëshmon edhe një artikull „Austria dhe Shqipëria”, i botuar më 30 shtator 1883 në „Fiamuri Arbërit”, Carigliano Calabro, ku, ndër të tjerash, thuhet: „Sllavët dhe Greqia e lehtë nga mendja shkon pas tyre përpiqen t’u presin krahët fiseve të Shqipërisë, që ende janë në grindje dhe luftojnë veç e veç në betejë. Sllavët e bëjnë këtë me qëllim që të bjerë Shqipëria, shtylla e fundit e Turqisë në Evropë dhe vendet e kësaj ta zërë sllavizmi, që do të vërshojë përmbi Apuljen deri te deti Adriatik”.⁷¹

Anipëse ende nuk na shkoi përdore të sigurojmë të dhëna të shumta për veprimtarinë e Lidhjes Shqiptare gjatë vitit 1884, prapëseprap, nëpërmjet të disa dokumenteve, kuptojmë se aktiviteti i saj nuk ishte shuar, përkundrazi, ishte gjallëruar akoma më shumë. Kështu, sipas Kirby Greenit, Lidhja Shqiptare ishte duke u përtri (of a rekindling of the Albanian League), aktiviteti i së cilës pasqyrohej në viset nga Shkodra deri në Prizren, e sidomos në kaza të Gjakovës, të Pejës dhe të Prizrenit.⁷²

Prandaj, siç na bënë me dije, J.E. Blunt, mbahej një korrespondencë aktive telefonike, në shifër, në mes të Portës së Lartë dhe të autoriteteve ushtarake në Selanik, në Manastir, në Kosovë (Prishtinë) dhe në Prizren, në lidhje me çështjen e Shqipërisë së Epërme.⁷³

Duket se shqiptarët e qytetit dhe të Sanxhakut të Prizrenit, siç na informon Blunti, kishin vendosur t’i kundërvehen veprimtarisë së regjistrimit të popullsisë dhe me anë të telegramit, ia parashtrojnë Portës kërkesat që pasojnë:

- 1) Tërheqja e menjëhershme e mytesarifit të Prizrenit.
- 2) Falja e shqiptarëve të dalluar (parësia shqiptare) të internuar nga Dervish pasha më 1881.
- 3) Ndërprerja e regjistrimit të popullsisë.
- 4) Falja e të dhjetës „extra” për qëllime arsimore të vendit.

Porta e kishte pranuar kërkesën e parë dhe kërkoi kohë për sa i përket kërkesave të tjera. Mirëpo, nga ana tjetër, shqiptarët e Dibrës, të Pejës dhe të Gjakovës kishin organizuar lëvizje kundër regjistrimit të popullsisë dhe kundër dhënies së të dhjetave „extra”. E Ahmet Ejup pasha,

⁷⁰ Public Record Office, London, *State Papers 93, General index 1873-1900*. Vol. 74, 932.

⁷¹ Z i h n i H a s k a j, *Mendimi politik e shoqëror i Rilindjes Kombëtare Shqiptare*, Vëllimi I (1879-1908), Tiranë, 197, 337.

⁷² *F.O. 424/136*, pp. 185. K. Green, Shkodër, 1 tetor 1884.

⁷³ *F.O. 424/136*, pp. 184, Konsulli i përgjithshëm J.E. Blunt kontit Granville, Selanik, 2 tetor 1884.

kryekomandant i Armatës së tretë ushtarake, e kishte nxitur Portën që të dërgonte përforcime në Shqipërinë Veriore.⁷⁴

Si rezultat i lëvizjes së vonshme shqiptare në Prizren mytesarifi dhe pasha ushtarak i Prizrenit pushohen nga detyra. Në vend të tyre emërohet Ibrahim pasha, i biri i Namik pashës, me fuqi të dyfishtë të pushtetit civil dhe ushtarak. Porta, mandej, në pajtim me kërkesat shqiptare, i ndërpreu operacionet e regjistrimit të popullit të Prizrenit, si dhe prizrenasve u premtoi se do të rekomandojë te Sulltani që të merren parasysht, në mënyrë të favorshme, kërkesat e tyre për faljen e taksës arsimore dhe për faljen e disa udhëheqësve të dalluar shqiptarë, të cilët, siç u vu në pah edhe më lartë, ishin internuar nga Dervish pasha (1881).⁷⁵

Rezistenca e shqiptarëve, të prirë nga udhëheqësit e shquar Sylejman Vokshi, haxhi Zeka, etj., dhe aktiviteti i Lidhjes Shqiptare të Prizrenit manifestohet edhe gjatë vitit 1885. Por, fatkeqësisht, të dhëna të shumta, për këtë periudhë, nuk kemi siguruar. Megjithatë, në bazë të disa burimeve osmane dhe të këngëtarit popullor, mund të hedhim dritë edhe për veprimtarinë e fundit të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit.

Në këtë mënyrë Abdyl Shulo, dëshmitar kundër Sylejman Vokshit, para Gjykatës së Jashtëzakonshme të Prizrenit, më 3 tetor 1885, ndër të tjerash, deklaroi:

Ahmet be Gjakova, Myrteza agë Gjakova dhe haxhi molla Zeka nga Peja ishin bashkëpunëtor të ngushtë të Sylejman Vokshit në të gjitha komitetet e Lidhjes antiqeveritare dhe në të gjitha veprimet kryengritëse që ishin zhvilluar deri më 1885. Ahmet be Gjakova për t'i luftuar organet qeveritare osmane e kishte shitur një çifllëk dhe për një kohë të gjatë kishte mbajtur në shtëpinë e vet, në Gjakovë, katërqind shqiptarë të armatosur. Me këta njerëz të armatosur ai i kërcënohej administratës qeveritare të vendit për çdo gjë sa herë që donte. E konfliktet e armatosura kishin ndodhur në rrethin e Prizrenit, në shkurt të këtij vitit (1885), në mes të kryengritësve shqiptarë dhe ushtrisë osmane nën komandën e Ibrahim pashës.⁷⁶

Kurse nga dëshmia e Ibrahim Çaushtit, dhënë po ashtu para Gjykatës Ushtarake, kuptojmë se çdo gjë që kishte ndodhur brenda shtatë-tetë vjetëve, jo vetëm në Gjakovë, por edhe në Dibër, në Shkodër, në Kosovë dhe në viset e Prizrenit, me një fjalë në të gjitha viset e Shqipërisë Veriore, në Gegëri, kundër Portës dhe ushtrive të Sulltanit, të gjitha ishin bërë me iniciativën, me udhëzimet, me nxitjen dhe me veprimet e Sylejman Vokshit. Në veprimet antishtetërore si bashkëpunëtorë të ngushtë të Sylejman Vokshit ishin Ahmet be Gjakova, Myrteza agë Gjakova dhe haxhi molla Zeka i Pejës. Ky i fundit ushtrinë kryengritëse shqiptare, e cila kishte luftuar kundër ushtrisë së Sulltanit, e kishte furnizuar me municion.⁷⁷

⁷⁴ Po aty.

⁷⁵ F.O. 424/136, pp. 187.

⁷⁶ Krista Priti, *Lidhja Shqiptare e Prizrenit në dokumente osmane 1878-1881* Tiranë 1978, 252-253.

E sipas dëshmitarit Sylejman, Sylejman Vokshi, që nga viti hixhri 1294 (1877) e deri më 1885, i kishte nxitur banorët e kazasë së Pejës dhe të Prizrenit kundër Portës së Lartë; kishte krijuar komitete antishtetërore në kaza të Gjakovës, të Pejës dhe të Prizrenit; ndikimi i tij kishte qenë shumë i madh sa që mjaftonte të jepte shenjë dhe e gjithë popullsia e Gegërisë të ishte në gjendje të luftonte deri në vdekje; po të kishte dashur Sylejman Vokshi kurrë nuk do t'i ishte vrarë mareshali Mehmet Ali pasha; Sylejman Vokshi, edhe prej kohës së ardhjes së Dervish pashës me ushtri (1881) e kishte nxitur popullsinë kundër ushtrive perandorake; kur komandanti i jashtëzakonshëm, Vesel pasha, ishte dërguar nga Stambolli për të shtypur lëvizjen kryengritëse në Kosovë, në fillim të shtatorit 1885, Sylejman Vokshi, derisa nuk ishte kapur nga forcat ushtarake osmane, kishte luftuar kundër tij.⁷⁸

Për ngjarjet e shtatorit të vitit 1885 këngëtari popullor thotë:

VESEL PASHA NË GJAKOVË

Baba mret na u çue në kamë,

Po i thurret pasht, krejt kah janë;

Edha pashve u paska thanë:

— Cili ini, bre, ma azgan?

Vesel Pasha i ka thanë:

— Unë jam, babë, ma azgan.

— Ti azgan në kofshe qillue,

Banu gati, n'Gjakovë me shkue,

Se Gjakovën duhet me sunue!

— Ti qat fjalë, babë, falma mue!

Qafa e shkurt m'ka qillue,

E flas llafin pa u kujtue;

Se n'Gjakovë nuk muj me shkue,

Shumë azgana i kanë kallxue.

— Hiq, bre bir, s'ban pa shkue!

Për azgana e di vetë,

Ma kanë pre ka 'i pashë për vjet.

Baba mret na u ngërmue:

— Hiq nuk ban, për pa shkue!

Kqyre pasha çka ka marue,

Shum asker m'i ka tubue,

Bajraktart, krejt i ka tubue

Për Gjakovë i ka tfillue...

Çabratin me çadra e ka mlue,

Miftar e uligje i ka tubue,

N'qarshi t'Gjakovës paska shkue,

N'saraj askerin e ka çue.
Po zen pasha m'i qortue:
 — *Pse ju kshtu, o me punue?*
Qysh ju mretin mos me ngue,
O me mbret, qysh me liftue!
Bajram Xhepa çka ka marue,
Po zen vetllat me i terrue,
Po zen sytë me i rrotllue:
 — *Ah, bre pashë, ti qysh po thue?*
Unë kit ven gjith e kam sunue,
Kqyri shejat kah ja kam vnue,
Unë vetë, bre kam me sunue! (...)⁷⁹

Me arrestimin e Sylejman Vokshit, pra, mori fund edhe faza e katërt e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit. Lidhja e Prizrenit mund të thuhet se, tani, ishte shuar plotësisht. Megjithatë rezistenca e shqiptarëve kundër Perandorisë Osmane nuk kishte marrë fund. Përkundrazi ajo vazhdon edhe në të ardhmen. Kuptohet, shqiptarët, të prirë, tani, nga haxhi molla Zeka i Pejës, fillojnë organizativisht dhe politikisht të konsolidohen, të organizohen dhe të formojnë një lidhje të re, Lidhjen e Pejës.

Skënder Rizaj

RESISTANCE THE ALBANIAN MASSES AGAINST THE SUBLIME PORTE (1881-1885)

S u m m a r y

In the Albanian historiography, usually prevails the opinion that with occupation of Prishtine, Gjakova (Yakova, Djakova), and Peja (Ipek) (in April-May, 1881), the Albanian League of Prishtine was crushed down. However, „in reality, it only changed its outward form, and from a public political association it became a secret national society, a sort of *Carbonari*”.

According to the report of Berttram Buxton addressed to Kirby Green, who during a limited stay in Prishtine, May 31st and June 1st, 1881, succeeded in collecting some worth while informations, stands, among them, that of the arrest of Shaip Agha (the vicepresident of the Albanian League), by Dervish Pasha, and on the other hand, he stated that Hadji Omer and Süleyman Vokshi were still at liberty. He also mentioned that he was not allowed to go to Peja and Gjakova by Dervish Pasha, because he had not yet time to put things in order there. Mr. Buxton explained how he was not politely treated by the Turks, and in spite of that, people in the streets did not look upon him and his followers with any suspicions and they were able to walk about the town without the least danger of molestation.

⁷⁹ *Këngë popullore të Rilindjes Kombëtare*, IAP, (Përgatitur nga: Sh. Pllana, Rr. Berisha, S. Fetiu), Prishtinë, 1978,

Therefore, in accordance with the report of Consul-General, Blunt (June 14th, 1881), Dervish Pasha pursues a moderate and lenient policy towards the Albanian Chiefs, who it appeared had been overawed by his late military operations against the League. Afterwards, in Upper Albania existed symptoms of considerable agitation, particularly in the districts of Peja, Gjakova, and Dibra. It appears, that the taking of the Census, as ordered by Dervish Pasha, was strongly objected by the inhabitants, and it had given rise to acts of insubordination in more than one locality.

Whereas, as far as the Albanians resistance is concerned, Mr Kirby Green in his report to Earl Granville of the 22th August, 1881, states „that Dervish Pasha was meeting with opposition from the mountaineers around Gjakova in his attempt to carry out the conscription among them”. So that, „the mountaineers bound themselves under a very solemn „bessa”, or engagement, to assist each other, whenever needful, in resisting to the utmost the slightest attempt of the Turkish Pasha to encroach upon their privileges, or to make them subject to the military levy”. How strong this well-known engagement of the mountaineers was, proved the fact when Dervish Pasha ordered Hadji Osman Pasha, the commander at Gjakova, to send two battalions of Nizams (regular troops) to the important village of Isnik and subject it to the conscription. There they were surrounded by a body of about 3.000 Albanian warriors. The Turkish troops being seized by a panic broke and fled in the greatest disorder back to Gjakova.

Soon after by the signal of danger given by the villagers of Isnik right away assembled about 7.000 mountaineers and appeared in the vicinity of Gjakova with the intention of attacking Hadji Osman Pasha and his battalions.

This was the prudent counsels of Suleyman Vokshi, one of the commanders at the battle of Shtimlja.

In connection with these tempestuous events „the Serbian Newspaper” (Srpske novine) says: „It is, already four months that Albanians have been stired up against the Turkish troops, and until now, the Albanian Movement (League) has not only crushed down, but, on the contrary, it took up as many elan, so that Albanians, in the last battle, defeated Dervish Pasha's troops”

According to A. Evans, who visited Vilayet of Kosova and Monastir in 1883 it is said: „at the present moment the Albanian League may be said to be dormant, but there is ample evidence of the prolongation of the movement of which it was a symptom (...) They (the Turks) speak with more than tolerance of the Albanian idea of forming a vassal State under the Sultan, and I have heard Turkish officers here openly exerate Dervish Pasha, whose treacherous seizure of the Albanian Chiefs at Shkupi (Üsküb) put a temporary extinguisher on the *League*”.

So, the fourth period of the Albanian League is the longest one. It lasted four years (from May, 1881 to September, 1885). The League began to consolidate, to revive; now, led by Süleyman Vokshi. It created new committees of the League, and its democratic partisan troops. It organised successful military actions against the Turkish troops. The League requested the immediate recall of the Mutessarif of Pristina, appointed by the Sultan; pardon of Albanian Notables exiled by Dervish Pasha in 1881; discontinuance of the Census by the Porte; it organized the Albanian people not to give their sons for the Turkish regular army; and requested remission of extra tithe leviable for educational purposes.

